

**Njoftimi i përqendrimit me të cilin AUTOCONT a.c. Republika Çeke, do të fitoj kontrollin mbi
Aksiell a.r.o.(Axiell s.r.o.), Republika Çeke**

(lënda nr. 08-136/2022)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 28.09.2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin **AUTOCONT a.c.** me seli në Hornopolni 3322/34, Moravska Ostrava, 70200 Ostrava, Republika Çeke, synon të fitoj kontrollin e plotë mbi shoqërinë **Aksiell a.r.o.(Axiell s.r.o.)**, me seli në Pragë 5-3liçn, Ha Radosti 106/64, Kodi postar 15521, Republika Çeke.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

AUTOCONT a.c. është një kompani që fokusohet në zbatimin e projekteve të ndërmarrjeve të mëdha dhe klientëve të mëdhenj, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit të Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturë TI, aplikacione të korporatave, mbështetje për proceset e biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e TI-së. Ajo është një kompani që i përket Grupit KKCG.

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, naftën dhe gazin, patundshmëritë, industrinë dhe teknologjinë e zgjuara. Grupi menaxhon më shumë se 30 kompani në 18 vende të botës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, KKCG Group është i pranishëm në tregun e punës me terminale video lotarie dhe teknologji informatike nëpërmjet shoqërive të mëposhtme:

Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - lojërat e fatit dhe basteve;

Seavus SHPKNJ Shkup, me aktivitet parësor - programim kompjuterik dhe

Qendra edukative dhe zhvillimore Seavus SHPKNJ Shkup, me aktivitet parësor- arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër.

Synimi në transaksion janë mjete të caktuara si pjesë e biznesit që lidhet me teknologjinë e informatikës në pronësi të Aksiell s.r.o., një kompani që ofron zgjidhje inovative të TI-së për botuesit kulturorë në nivel global - për bibliotekat, arkivat, muzetë dhe shkollat.

Nëpërmjet transaksionit të planifikuar, Grupi KKCG do të fitoj kontrollin e vetëm mbi mjetet e përshkruara më sipër në pronësi të Aksiell s.r.o bazuar në transferimin e pronësisë së mjeteve nëpërmjet transferimit të një pjese të biznesit nëpërmjet të cilit Grupi KKCG do të fitojë pronësinë e një pjese të biznesit nga Aksiell s.r.o përmes shoqërisë së saj të varur me 100% në pronësi të AUTOCONT a.s.

Parashtruesi konsideron se tregu përkatës për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të përkufizohet si treg për shërbimet e teknologjisë së informatikës.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

13.10.2022

Shkup